



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Gjuhë dhe Letërsi Angleze (2022/2023)

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	180
Kodi	N-EN
Titulli	Profesor i gjuhës dhe letërsisë angleze
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-2502/1
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	14.07.2022

Përshkrimi i programit

Struktura e programit përmban studime, të cilat nga natyra janë dinamike, integruuese dhe ndërvepruese. Programi është dizajnuar të ofrojë qasje integruuese në tema nga fusha e gjuhëve, kulturave dhe komunikimeve, duke e implementuar këtë koncept nëpërmjet programit mësimor. Lëndët, të cilat janë përfaqësuar në këtë program paraqesin perspektiva të cilat bazohen në teorinë, e cila është e lidhur ngushtë me aplikimin praktik në botën e gjuhës, kulturës, artit, arsimit dhe komunikimit.

Qëllimet kryesore janë:

- T'i përgatisë studentët për pozitën e udhëheqësit në institucionet dhe organizatat arsimore, kulturore dhe shkencore në vend dhe kudo në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtimin e karrierës në fushën e profesionit të tyre në sektorin shtetëror, privat dhe joqeveritar.
- Të ofrojë një sërë modulesh që përfshijnë thelbin e dijes për përafrimin ndaj profesioneve, të cilat më pak ose më shumë janë të lidhura me fushën e arsimit dhe kulturës.
- Ta mundësojë arritjen e shkathtësive kërkimore dhe përvojë për gjuhën, literaturën dhe kulturën në organizatat publike, private dhe ndërkombëtare.
- Ta zhvillojë konceptin e mendimit kritik tek studentët.
- Ta mundësojë qasjen aktive të studentëve në ligjëratat dhe në kryerjen e kërkimeve të pavarura në të gjitha fushat e organizatave shoqërore, arsimore, kulturore dhe shkencore.
- Ta mundësojë zhvillimin e shkathtësive personale, pastaj shkathtësitë e komunikimit, për kërkime dhe shkathtësi të tjera të rëndësishme, të cilat janë të nevojshme për punësim.

Programi për studime deridiplomike studentëve iu ofron kuptim të thellë dhe njohuri nga fusha e arsimit dhe kulturës, ndërkohë i orienton në fusha të caktuara, të cilat do të specializohen në vitin e fundit të studimeve. Përbërja e programit studimor ka për qëllim kombinim të balancuar të njohurive themelore dhe shkathtësive specifike profesionale. Viti i parë është i rëndësishëm për studentët, për shkak se ndërlihd një spektër të plotë të lëndëve ndërdisiplinore. Kjo do të ketë dobi të konsiderueshme për formimin e tyre profesional.

Karriera

Anglishtja është gjuha e dytë në botë, kështu që, për të diplomuarit e programit tonë të anglishtes ka mundësi për punësim në mësimdhënie, përkthim, interpretim, gazetari, në industrinë e turizmit, mësimdhënie korporative të gjuhës, interpretime biznesi, redaktime dhe shkrim kreativ.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka njohuri teorike dhe praktike të strukturave gramatikore dhe vokabularit bashkëkohor anglez, që mjafton për përmbushjen e nevojave mësimore.
- Ka kompetencë gjuhësore të barabartë, ose më të mirë se Korniza e Përbashkët Evropiane në nivelin B2, në të gjitha shkathtësitë (të folurit, të dëgjuarit, lexim dhe shkrim).
- Ka njohuri të literaturës së gjuhës angleze sa u përket periudhave, zhanreve dhe autorëve kryesorë. njohuri praktike themelore të shkathtësive të përkthimit nga anglishtja e përgjithshme.
- Ka shkathtësi themelore praktike në lëndën e anglishtes
- Kupton strategji të ndryshme të mësimnxënies dhe mësimdhënies, të cilat përdoren në mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e huaj.
- Ka kuptim të mirë për aspektet e ndryshme të historisë dhe kulturës së shteteve që flasin anglisht.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Është i/e kualifikuar të ligjërojë në mjedise të ndryshme, në pajtim me ligjin për arsimim të Republikës së Maqedonisë.
- Aplikon metodikë të përshtatshme të mësimdhënies, e cila u përgjigjet nevojave të studentëve.
- Mund të përkthejë në anglisht dhe prej anglishtes në gjuhën amtare për përmbajtjen e mësimi.
- E përdor gjuhën angleze në mënyrë të përshtatshme sa i përket të folurit dhe llojeve të ndryshme të diskurseve në mjedise të ndryshme sociale dhe profesionale.

Aftësitë për të vlerësuar

- Ka aftësi të vlerësojë tekste literature, duke u kujdesur për paqartësitë e gjuhës, stilit të literaturës, simbolit dhe metaforës.
- Mund të sjellë vendim të qartë dhe informues për çështje dhe debate në bazë të njohurive gjuhësore, kulturore dhe të literaturës.
- Ka aftësi t'i analizojë nevojat e studentëve dhe të zhvillojë programe mësimore me zgjedhje të teknikave të përshtatshme si dhe dizajnim të programeve mësimore.

Aftësitë e komunikimit

- Mund t'i artikulojë në mënyrë të qartë mendimet dhe t'i transferojë mesazhet në gjuhën angleze akademike dhe të folur.
- Ka aftësi të prodhojë dhe të organizojë gramatikiisht fjali dhe shprehje të sakta.
- Zotëron me njohuri për lexim me vetëbesim, shkrim dhe të folurit për një numër të madh të teksteve letrare, si dhe shkruan argumente të qarta, duke përdorur shembuj tekstualë me progres të logjikshëm dhe qartësi të të shpjeguarit.
- Mund t'i vlerësojë dhe t'i notojë trendët kulturore në botën anglofone, duke përfshirë mendimtarët dhe ngjarjet historike.

Aftësitë e të mësuarit

- Ka aftësi të pavarura të të mësuarit gjatë bërjes së detyrave profesionale dhe mund të tregojë pavarësi në aplikimin e tyre në sferën profesionale.
- Është në gjendje të zhvillojë materiale mësimore në lidhje me praktikën e tij/saj mësimore, duke përdorur udhëzime dhe resurse të përshtatshme.
- Ka kapacitet të marrë pjesë në ngjarjet e reja gjuhësore dhe kulturore në studimet e anglishtes dhe t'u përshtatet atyre.
- Mund të përdorë dhe të praktikojë të mësuarit e përgjithshëm.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CEL-105] [6.0 SETK] **Anglishtja bashkëkohore 1**
- [C2199] [6.0 SETK] **Letërsia angleze 1: Letërsia Britanike**
- [ETTE04] [3.0 SETK] **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**
- [CEL-103] [6.0 SETK] **Fonetikë dhe fonologji**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**

Semestri 2

- [CEL-205] [6.0 SETK] **Anglishtja bashkëkohore 2**
- [CEL-202] [6.0 SETK] **Morfologjia**
- [C2200] [6.0 SETK] **Letërsia angleze 2: Letërsia amerikane**
- [CELT08] [3.0 SETK] **Anglishtja për qëllime specifike**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**

Semestri 3

- [C2069] [3.0 SETK] **Komunikim verbal**
- [C2201] [3.0 SETK] **Anglishtja bashkëkohore 3**
- [CEL-802] [6.0 SETK] **Familja dhe shoqëria**
- [E2203] [6.0 SETK] **Letërsia angleze 3: Letërsia irlandeze**
- [C2202] [6.0 SETK] **Historia dhe kultura e Britanisë së Madhe**
- [CTTA56] [6.0 SETK] **Sintaksa**

Semestri 4

- [C2205] [6.0 SETK] **Historia dhe kultura e SHBA**
- [EEL-301] [6.0 SETK] **Hyrje në të përvetësuarit e gjuhës së dytë**
- [LCC-803] [6.0 SETK] **Inkluzioni i studentve me nevoja të veçanta**
- [CEL-504] [6.0 SETK] **Përkthim 1**
- [C2204] [3.0 SETK] **Anglishtja bashkëkohore 4**
- [C2070] [3.0 SETK] **Komunikim me shkrim**

Semestri 5

- [CEL-603] [6.0 SETK] **Përkthim 2**
- [CEL-503] [6.0 SETK] **Testimi dhe vlerësimi**
- [C2206] [6.0 SETK] **Linguistikë e zbatuar: ELT 1**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Semestri 6

- [CEL-602] [6.0 SETK] **Analiza e nevojave dhe përpilimi i kurrikulave**
- [C2207] [6.0 SETK] **Linguistikë e zbatuar: ELT 2**
- [C2211] [6.0 SETK] **Praktikum**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Description of courses

Lëndë obligative

• **Anglishtja bashkëkohore 1**

Qëllimet e programit të lëndës: Njohuritë dhe të kuptuarit: Ka njohuri dhe kuptim për përdorimin e drejtë të kohëve të foljeve, krahasimit të mbiemrave, të folurit indirekt, për paskajoren dhe për supozime logjike. Të ketë kompetencë gramatikore dhe të vokabularit për të marrë pjesë në diskutime rreth temave me përmbajtje sociale dhe të tjera. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Ai/ajo është në gjendje t'i aplikojë njohuritë e tij/saj në situata të ndryshme komunikuese dhe për t'iu përgjigjur me një dozë të lartë të saktësisë gjuhësore mbi tema të ndryshme të debatit. Ai/ajo ka njohuri të pyesë dhe të shprehet, të kundërshtojë dhe spekulojë ide, të bëjë oferta dhe të kundërshtojë ide, por dhe të sugjerojë. Aftësitë e komunikimit: Studenti është në gjendje të fillojë dhe të mbajë një diskutim me një dozë të konsiderueshme të vështirësisë së lëmisë. Ka njohuri dhe kompetencë të shkruajë një korrespondencë me paragrafë të mirë-organizuar, por edhe korrespondencë të mirë me shkrim. Studenti ka zhvilluar aftësi, të cilat mundësojnë leximin efektiv. Vlerësimi: Studenti është i aftë për të përdorur rregullat forma të ndryshme gramatikore, të tilla si kohë, ndërtime verbale, idioma dhe të tjerët. Ai/ajo është i, e aftë për të shprehur mendime të mirë-organizuar mbi tema të ndryshme të debatit. Aftësitë e të mësuarit: Studentët kanë zhvilluar aftësi për mësim të pavarur përmes mjeteve të ndryshme ndërvepruese. Ata janë në gjendje të gjejnë burime për të mësuar mëtej dhe për të përmirësuar katër aftësitë (lexim, dëgjim, shkrim dhe të folur).

• **Letërsia angleze 1: Letërsia Britanike**

Qëllimet e programit të lëndës: Njohuritë dhe të kuptuarit e studentëve: • Përdorimi i studimeve paraprake për poezi dhe prozë dhe e kritikës së dramave të mëparshme; • Lidhja e zhvillimit të dramës angleze me sfond historik dhe kulturor që ata kanë bërë. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: • Përdorimi i terminologjisë së duhur kritike me shkrim dhe në të folur; • Kontrollimi karakteristikave të mëdha dhe specifikat e fushës. Aftësitë për të vlerësuar: • Analizon i veprave dramatike si vepra letrare dhe të performuara; • Zbulimi, analiza dhe interpretimi i dallimeve të mëdha midis dramaturgëve dhe autorëve të mëdhenj. Aftësitë e komunikimit: • Lexon veprat origjinale në gjuhën angleze; • Krahasime, hulumtime dhe të shkruarit një ese me kolegët e të njëjtës radhë; • Formularë, shfaqje, mbështetje mendimesh kritike të tekstit dhe diskutime me instruktorin dhe kolegët. Aftësitë e të mësuarit: • Lexon veprat si tekst, por edhe si interpretim; • Diskutimi i përshtatshëm në orë, interpretimi personal dhe ese të pavarur hulumtues; • Përdorimi i performancës për informacion, ndikimi dhe të kuptuarit të thellë të tekstit

• **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve t'i përdorin aftësitë e gjuhës në kontekstin e shkrimit akademik që përfshin të shkruarit një ese akademik, paragrafë dhe ese me të cilat arsyetohet problemi dhe ofrohet një zgjidhje, krahasohen dhe konstatohen situata dhe probleme dhe elaborohet teza ose mendimin. Më tutje, studentët duhet të jenë të aftë të dëgjojnë dhe të lexojnë dhe ta kuptojnë thelbin dhe detajet dhe të shkruajnë me sukses një paragraf me të cilin e argumentojnë mendimin e tyre. Po ashtu, studentët duhet t'i organizojnë pikëpamjet dhe mendimet e tyre, të cilat do jenë të justifikuar në një paragraf të caktuar apo ese. Gjithashtu, duhet t'i organizojnë idetë e tyre dhe të shkruajnë me sukses një paragraf dhe ese duhet shpjeguar problemin, por dhe të propozojnë një zgjidhje, e cila jep detaje, fakte dhe argumente dhe përmend burime. Ata, duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe detajet në tekst, objektivat dhe mesazhet e tekstit, si dhe mënyrat e organizimit të tekstit dhe t'i aplikojnë me shkrim. Në fazat e avancuara, studentët pritet të kalojnë në shkrimin e detyrave akademike që janë më komplekse, si p.sh. një punim akademik me shqyrtim të literaturës, hulumtim, konkluzione dhe rekomandime.

• **Fonetikë dhe fonologji**

Lënda fokusohet në konceptet themelore të fonologjisë, siç janë shpikja dhe shpërndarja e fonemave të anglishtes, tingujve, karakteristikat e tyre, morfo-fonologjia, struktura e rrokjes dhe karakteristikat e theksit. Po ashtu, fokusohet edhe në fonetikën akustike, artikulative dhe auditive, duke përfshirë edhe përshkrimin dhe klasifikimin e bashkëtingëlloreve të anglishtes, zanoret e thjeshta dhe të përbëra.

• **Anglishtja bashkëkohore 2**

Qëllimet e programit të lëndës: Njohuritë dhe të kuptuarit: Të ketë njohuri dhe t'i kuptojë strukturat gramatikore si bie fjala pasivin, fjalitë kushtore, lidhëzat, strukturat, e theksuara, klauzurat, etj. Po ashtu, të ketë kompetencë gramatikore dhe të vokabularit, të marrë pjesë në diskutimet mbi tema të ndryshme sociale dhe përmbajtje të tilla, si: mjedisi, ekologjia, teknologjia, shkenca, moda etj. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Studenti duhet të jetë në gjendje t'i aplikojë njohuritë e veta në situata të ndryshme komunikuese dhe t'iu përgjigjet me një dozë të lartë të saktësisë gjuhësore temave të ndryshme të debatit. Ka njohuri të shprehë interes dhe shqetësim, supozim i shprehur dhe interes për të kërkuar falje, të ankohet, përsëris dhe të konfirmoj. Aftësitë e komunikimit: Studenti është në gjendje për të filluar dhe të mbajë një diskutim me një të vështirësi të kënaqshme. Ka njohuri dhe kompetencë për të shkruar ese të mire-organizuar dhe të organizojë korrespondencën e shkruar mirë. Është i aftë ta zbatojë diturinë e vet në rrethana të ndryshme komunikuese dhe tu përgjigjet me një dozë të lartë të përpikërisë linguistike temave të ndryshme për debat. Ka dituri të tregojë interesim dhe kujdes, ta thotë supozimin, të pyesë dhe të tregojë interesim,

të ankohe, të kërkojë falje, të përsërisë dhe të pohojë. Aftësitë për të vlerësuar: Studenti është i aftë t'i përdorë rregullat dhe format e ndryshme gramatikore, si: kohët, konstruktionet foljore, idiomat etj. Ai / ajo është i aftë për shprehjen e mendimeve të organizuara mirë në tema të ndryshme të debatit, si për shembull: krimi, moda, kushtet e motit, ekologjia, teknologjia, etj. Aftësitë e të mësuarit: Studentët kanë zhvilluar aftësi për mësim të pavarur me ndihmën e mjeteve të ndryshme interaktive. Ata janë në gjendje të gjejnë burime për të mësuar mjet dhe për të përmirësuar katër aftësitë (lexim, dëgjim, shkrim dhe të folur).

• **Morfologjia**

Lënda koncentrohet në karakteristikat morfologjike të gjuhës angleze. Ajo i merr parasysh, i trajton edhe kategoritë gramatikore dhe funksionet tjera të fjalëve të gjuhës amtare të studentëve, siç janë: emrat, përemrat, mbiemrat, ndajfoljet, paraafjalët, nyjat e shquara dhe të pashquara, lidhëzat, numrat dhe pasthirrat. Me kujdes të veçantë trajtohen format dhe funksionet e pjesëve të lartpërmendura të ligjëratës.

• **Letërsia angleze 2: Letërsia amerikane**

Qëllimet e programit të lëndës: Njohuritë dhe të kuptuarit: • Përdorimi dhe kuptimi i vokabularit të duhur kritik lidhur me poezinë dhe modelet poetike; • Angazhimi i aftësive kritike në interpretimin e teksteve poetike; • Demonstrimi i të kuptuarit historik të poetëve, jeta e tyre, stilet e tyre dhe arritjet e tyre. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: • Prezantimi dhe vlerësimi i zhvillimit të poezisë angleze nga Çoseri (Chaucer) dhe Larkin (Larkini). • Identifikimi i temave të ngjashme, në poezi dhe analiza dhe trajtime të ndryshme. • Lidhja e zhanreve specifike, stilet dhe lëvizjet me kultura të përshtatshme në periudha të caktuara kronologjike. Aftësitë për të vlerësuar: • Përcaktimi i niveleve të ndryshme të anashkalimit në shkrimin e poezisë. • Gjenerimi dhe artikulimi i lavdërimeve të interpretuara në vjershë. • Vlerësimi i përshtatshmërisë së formës së vargjeve dhe metrika. Aftësitë e komunikimit: • Leximi i punimeve në formën e tyre origjinale në gjuhën angleze. • Kryerja e hulumtimeve të kujdesshme në një ese të shkruar dhe paraqitja e gjetjeve në klasë. • Përfshirja në diskutimin kritik dhe estetik të materialeve të studiuara me ligjërues dhe anëtarë të tjerë të klasës. Aftësitë e të mësuarit • Leximi dhe interpretimi i artit në gjuhë angleze të avancuar. • Lidhja e kritikave lidhur me punimet studiuara në klasë dhe përfshirja e kritikave më bindëse duke interpretuar vet studentit. • Arritja e një vokabulari të pazakonshëm teknik bazuar në kontekst dhe në shembuj.

• **Anglishtja për qëllime specifike**

Lënda synon t'i pajis studentët me njohuri për gjuhën angleze me qëllime specifike (ESP), si një degë e veçantë e gjuhës angleze, e ndryshme nga ajo e përgjithshme angleze (GE); historia e zhvillimit dhe klasifikimit të kësaj fushe, si dhe karakteristikat kryesore duke përfshirë zhanre të ndryshme, veçoritë e tyre specifike dhe auditorin. Për më tepër, kjo lëndë do të përpunojë dhe do të trajtojë fjalorin dhe ligjërimin aktual nga llojet kryesore të ESP-ve si anglishtja për biznes, anglishtja për drejtësi, anglishtja për mjekësinë, tregtia, dizajni, etj., përmes punës me materiale autentike në mënyrë që studentët të krijojnë njohuri me specifikën e gjuhës së profesioneve të ndryshme që ata mund të hasin në karrierën e tyre të ardhshme, si mësimdhënës ose përkthyes.

• **Komunikim verbal**

Objektivat e programit të lëndës: - Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit verbal. - Të jenë në gjendje të përfshihen aktivisht në një diskutim mbi një temë të veçantë. - Të zotërojnë teknikat për komunikim të suksesshëm. - Të shprehin mendimin e tyre kritik për tema të caktuara. - Të zbatojnë teknikat e adaptuara në karrierën e tyre profesionale.

• **Anglishtja bashkëkohore 3**

Studentët në këtë lëndë do t'i pasurojnë përvojat e tyre gjuhësore: Njohuritë dhe të kuptuarit: - Përdorimi i strukturave komplekse gramatikore si fjali të varura dhe pyetje indirekte; zhvillimi i ndjeshmërisë ndaj kulturave angleze dhe stili i komunikimit. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: - Ndërrprerje e bisedës me edukatë dhe në mënyrë të sjellshme të kontribuohet në diskutimet në klasë; spekulime në diskurs; formimi i fjalive më të sakta gramatikore dhe stilistike që tregojnë përdorimin e drejtë të formave të foljes, krahasime dhe gjuhë përshkruese. Aftësi komunikimi: - Duke shprehur përparësi, pakënaqësi, qëllime, ndjenja dhe ankesa; shkrimi i esëve dhe korrespondencës zyrtare, zhvillimi i të folurit dhe të shkruarit rrjedhshëm. Aftësitë për të vlerësuar: - Rishikimi i shkrimit, leximit dhe dëgjimit për motivin kryesor dhe detajet, duke shprehur gjuhën e hetimit dhe tendencave dhe eksplorimi i konteksteve të tyre të ndryshme; shfrytëzimi i gjuhës së përshtatshme në një situatë të dhënë, duke përfshirë edhe aspekte të tjera, por jo të kufizuara në shprehje akademike dhe të përditshme. Aftësitë e të mësuarit: - Pasurimi i përvojës së tyre kulturore dhe i dijes në shfrytëzimin e teksteve ekspresive dhe skenarëve për nxitjen e të mësuarit të pavarur; menaxhimi i burimeve gjuhësore, siç janë: shërbimet e ueb-it dhe ato bibliotekare; shfrytëzimi i gjuhës angleze për zgjidhjen e problemeve për mësim.

• **Familja dhe shoqëria**

Qëllimet e programit të lëndës: - Studentët, do të fitojnë njohuri më të thella për kushtet shoqërore në të cilin zhvillohet arsimi, familja dhe shoqëria; - Specifikat e familjes dhe shoqëria si një disiplinë sociologjike; - Pabarazitë në arsim; - Do të mund të bëjnë analiza më të thella të familjes dhe shoqërisë dhe të faktorëve aktorëve socialë në të; - Do të mund të zhvillojnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj teorisë dhe praktikës arsimore në një shoqëri veçantë; - Iniciojnë dhe kompletojnë hulumtime të pavarura; - Do të zhvillojnë aftësi për përshtatje në marrëdhënie dhe rrethana të ndryshme kulturore dhe ndërnjerëzore; - Demonstrojnë aftësi për transferin e diturisë në lidhje me kompleksitetin e reperkusioneve sociologjike, antropologjike të teknologjive të komunikimit; - Aftësi për të zhvilluar diskutime elokumente.

- **Letërsia angleze 3: Letërsia irlandeze**

Lënda shqyrton një nga kulturat kryesore letrare të gjuhës angleze: shkrimin e Irlandës. Nuk studion shkrimin në gjuhën irlandeze. Lënda studion një nga vendet dhe kulturat kryesore që kontribuojnë në literaturën në gjuhën angleze në botë.

- **Historia dhe kultura e Britanisë së Madhe**

Qëllimi i lëndës është që studentët: • Të kenë mirëkuptim për aspekte të ndryshme të historisë dhe kulturave të vendeve anglishtfolëse; • Të eksplorojnë perspektiva të ndryshme të historisë së vendeve që flasin anglisht (me fokus në Mbretërinë e Bashkuar) jo aq sa sekuencat e ngjarjeve, por më shumë si procese; • Të vlerësojnë tiparet e bollshme të shoqërive multikulturore; • Të angazhohen në diskurs në lidhje me historinë shoqërore (ekonomike, demografike, politike dhe kulturore), të Anglisë.

- **Sintaksa**

Qëllimet e lëndës: T'i përvetësojnë konceptet dhe kategoritë e sintaksës së gjuhës angleze me një theks të veçantë në aplikimin pedagogjik; dituria e tyre teorike dhe praktike e sintaksës së gjuhës angleze, të jetë në nivelin e duhur me nevojat e mësimi të gjuhës angleze; Të mund ta përvetësojnë gjuhën angleze, jo vetëm si një seri komplekse të modeleve sintaksore dhe leksikore, por të aftësohen me një kompetencë të tillë gjuhësore me të cilën do t'i njohin dhe do t'i përdorin këto modele në kontekste përkatëse socio-kulturore; Të kenë njohuri të burimeve të literaturës së mësimdhënies së sintaksës së gjuhës angleze; Të jenë të trajnuar me njohuri dhe shkathtësi për të kryer një krahasim për dallimet dhe ngjashmëritë mes gjuhës amtare dhe gjuhës angleze.

- **Historia dhe kultura e SHBA**

Studentët: - Do të fitojnë njohuri të mirë të aspekteve të ndryshme të historisë dhe kulturës së vendeve të botës anglishtfolëse; - Do t'i analizojnë perspektivat e ndryshme të historinë amerikane më shumë si një proces se sa si ngjarje të njëpasnjëshme kronologjike; - Do ta kuptojnë ndërveprimin në mes të zhvillimit politik dhe ekonomik dhe ndryshimit shoqëror (p.sh. në fushën e të drejtave të grave, të drejtave civile, etj.), dhe gjithashtu do të mësojnë t'i vlerësojnë faktorët e përfshirë në zhvillimin e SHBA-ve si një shoqëri shumëkulturore; - Do të jenë në gjendje të angazhohen në mënyrë kritike në një analizë të diskursit të historisë sociale të Shteteve të Bashkuara (ekonomike, demografike, politike, kulturore).

- **Hyrje në të përvetësuarit e gjuhës së dytë**

Kjo lëndë u mundëson studentëve hyrje në fushën e përvetësimit të gjuhës së dytë (SLA). Studentët fitojnë një bazë të mirë në teorinë SLA dhe trajnim për një nga ndihmat metodologjike të fundit të kësaj fushe. Një periudhë e konsiderueshme do t'u përkushtohet ngjashmërive dhe dallimeve në mes përvetësimit të gjuhës amtare dhe të huaj dhe studentët do të kenë rast të reflektohen në përvojat e veta të mësimnxënies. Temat e përfshira janë: procesi i SLA, ndikimi i moshës së studentit, strategjitë individuale të mësimnxënies në këtë proces, roli i gjuhës amtare dhe të huaj në mësimnxënie, aftësitë komunikuese, gabimet dhe analizimi i gabimeve, hipoteza e periudhës kritike, trajnim strategjish.

- **Inkluzioni i studentve me nevoja të veçanta**

Qëllimi i lëndës është inkluzioni i të gjithë studentëve që në zhvillimin e tyre mund të kenë anomali mendore apo fizike në shkallë të ulët. Si qëllim tjetër është që studentët, duke qenë të inkorporuar së bashku me moshatarët e tyre, më së miri mund të mësojnë e të përparojnë se sa duke i ndarë në grupe të veçanta. Këta studentë me kujdes të madh duhet të trajtohen dhe të punohet me ta në forma dhe metoda të veçanta. Kjo kategori mund të kenë handicap të shikimit, të dëgjimit, mund të jenë me paralizë cerebrale dhe gjithçka çka mund të jetë e caktuar si diagnozë nga mjeku. Integrimi i kësaj kategorie paraqet një risi në procesin e mësimdhënies bashkëkohore.

- **Përkthim 1**

Lënda hulumton metodat, teknikat, qasjet dhe teoritë e përkthimit. Jep instruksione për përkthim të suksesshëm dhe për një interpretim të rrjedhshëm të pandërprerë. Fokusi është në përkthimin e teksteve letrare si proza dhe poezia.

Edhe dokumente të tjera analizohen dhe përkthehen, si p.sh. artikuj gazetalesh, dokumente oficiale dhe tekste profesionale nga fusha e biznesit, drejtësisë, dhe administratës. Lënda, po ashtu, hulumton etikën, moralin dhe përgjegjësitë e të përkthyerit.

- **Anglishtja bashkëkohore 4**

Studentët në këtë lëndë do t'i pasurojnë përvojat e tyre gjuhësore: Aftësitë e komunikimit Dërgimi i llogarisë, blerja e gjërave, tregim përvojash, kontrast idesh, shprehje ndjenjash, ndjekje diskursesh; bërje propozimesh përkatëse, shprehje gjasash, përparësi/mangësi, vendos për ushqim/pije dhe shpreh pajtim/mospajtim. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit Miratojnë ide, shprehin bezi/simpat, bëjnë refuzime, japin propozime, pranojnë/refuzojnë/sjellin vendime; japin komplimente, alternativa; bën supozime; prodhojnë shumë fjali të sakta gramatikisht dhe stilistikisht të cilat tregojnë përdorimin e saktë të formave foljore dhe formave pasive. Aftësitë për të vlerësuar Rishikimi i shkrimit, leximit dhe dëgjimit, detajet kryesore, hetimet kërkimore, trendët në kontekste të ndryshme, duke përdorur gjuhën e përshtatshme në një situatë të caktuar, duke përfshirë shprehje akademike dhe sociale. Njohuritë dhe të kuptuarit Përdorimi i strukturave komplekse gramatikore, si klauzola të koncesionit, folje modale, pasive, kuantifikatorë, pyetje indirekte; përdorim i vokabularit të lidhur me kriminalistikën, evolucionin e arsimit, trashëgiminë, hapësirën dhe ushqimin; zhvillimi i ndjeshmërisë së anglo -kulturave dhe stili i komunikimit. Aftësitë e të mësuarit Pasurimi i përvojës kulturore dhe njohurive me përdorimin e teksteve dhe skenarëve shprehëse për nxitjen e të mësuarit të pavarur; kompetencë hulumtuese dhe strategjike, menaxhim me burimet gjuhësore siç janë: ueb faqet dhe shërbimet bibliotekare; përdorimi i gjuhës angleze zgjidhjen e problemeve të mësimit..

- **Komunikim me shkrim**

Objektivat e programit të lëndës: Për të fituar njohuri në lidhje me procesin e të shkruarit (fazat në krijimin e një teksti). - Të miratojnë normat standarde të gjuhës. - Të arrihet një nivel akademik për shprehje me shkrim në shqip, maqedonisht ose anglisht, i cili do të zbatohet njohuritë e marra më parë të gjuhës standarde. - Të inkurajojë motivimin e studentëve për shprehje me shkrim pavarësisht nga llojet dhe format e tekstit. - Të miratojnë kriteret e tekstualitetit, të cilat janë thelbësore për një tekst. - Përvetësimi i aftësive për kërkimin e materialeve (biblioteka dhe burimet online).

- **Përkthim 2**

Lënda mundëson informata të reja që lidhen me ligjëratat dhe mësimin e vokabularit në klasat e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Përfshinë përkthimin e asaj si mësohet vokabulari, si përdoret në të folur e me shkrim dhe diskutime për praktikën më të mira momentale të mësimdhënies së vokabularit. Pyetjet specifike të përfshira në këtë lëndë janë: çfarë domethënë të dish një fjalë, sa fjalë ka, cilat fjalë duhet të mësohen, në mënyrë të hapur është kundër mësimit të rastësishëm të vokabularit, vlera e leximit në mësimin e vokabularit, strategjitë e mësimit të vokabularit, teknikat e mësimdhënies së vokabularit dhe testimi i vokabularit.

- **Testimi dhe vlerësimi**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i bëjë të afërta parimet themelore të nevojshme për përgatitje dhe aplikim të procesit të vlerësimit. Përmes njohjes me këto parime studentët i identifikojnë edhe llojet më të rëndësishme të vlerësimeve, dallimin ndërmjet vlerësimit standard dhe alternativ. Një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi është vlefshmëria dhe besueshmëria e instrumenteve të vlerësimit. Gjatë semestrit studentët, gjithashtu, do të njihen me lloje të ndryshme të testeve, lloje të pyetjeve dhe detyrave të duhura gjatë dizajnit të testeve dhe implementimit të procesit të vlerësimit dhe notimit.

- **Linguistikë e zbatuar: ELT 1**

Kjo lëndë ka për qëllim që të njoftojë studentët me gjërat bazike të mësimdhënies së anglishtes si gjuhë e huaj, si dhe elementet kryesore të planifikimit të orës mësimore dhe organizimit të mësimit. Me qëllim që të arrihet kjo, do të theksohen principet e seleksionimit dhe aplikimi i teknikave të ndryshme në mësimdhënien e aftësive gjuhësore, shqiptimin e fjalëve, vokabularit dhe gramatikës. Nëpërmjet këtyre ushtrimeve studentët do të marrin përvojë në dhënien dhe marrjen e informatës kthyesë të performancës së tyre. Studentët, do të reflektojnë në secilën njësi tematike më qëllim të zhvillimit të menduarit kritik, si një aftësi shumë e rëndësishme jetësore. Studentëve do të iu prezantohen aktivitete të ndryshme për nxënësit e rinj me qëllim të zbatimit në karrierën e tyre të mësimdhënies në të ardhmen.

- **Analiza e nevojave dhe përpilimi i kurrikulave**

Lënda ka për qëllim të njoftojë studentët me parimet bazë të nevojshme për përgatitjen dhe aplikimin e lëndëve moderne akademike. Me anë të njohjes me këto parime studentët mund ta bëjnë dallimin në mes të lëndëve të ndryshme varësisht nga nevojat e studentëve dhe tregut. Një element shumë i rëndësishëm në këtë proces është

kontrollimi i vlefshmërisë dhe besueshmërisë së instrumenteve të përdorura në procesin e vlerësimit dhe përpilimit të lëndës sipas standardeve dhe parimeve të njohura në akademi dhe pedagogji.

- **Linguistikë e zbatuar: ELT 2**

Kjo lëndë ka për qëllim që t'ju ndihmojë studentëve të hulumtojnë mësimdhënien e anglishtes me thellë. Po ashtu, lënda ju ndihmon studentëve që të aplikojnë principet dhe qasjet e metodave të mësimdhënies në planifikimin e orës mësimore duke e organizuar një orë të shkurtër. Studentët, do të kenë mundësinë që të zhvillojnë materiale për mësim, si dhe njësi mësimore, të zgjedhin vështirësi në mësimdhënie, të marrin pjesë dhe të reflektojnë në observimet që do të ua bëjnë kolegëve të tyre në klasë, si dhe tu japin informata kthyesë. Deri në fund të lëndës, studentët, do t'u ekspozohen teknikave të ndryshme të mësimdhënies të cilat do të mund të përdoren në rrethana të ndryshme të mësimi dhe në zhvillimin e të menduarit kritik, i cili do tu ndihmojë në karrierën e tyre të mësimdhënies.

- **Praktikum**

Lënda ka për qëllim të përgatisë studentët për mësimin e praktikës EFL / ESL për nxënësit në një shkollë të mesme përmes punëtorisë (ve), vëzhgimeve të mësuesit me përvojë në veprim dhe praktikës në klasë, duke punuar me nxënësit aktualë të gjuhës angleze. Theksi vihet në vëzhgimet, reflektimin mbi vëzhgimet, demonstrimet e mësimdhënies dhe përgatitjen e planeve mësimore. Të gjitha këto aktivitete bëhen për të ndihmuar studentët ta zhvillojnë filozofinë e tyre të mësimdhënies. Çdo gjë që bëhet në këtë lëndë është projektuar për të përmirësuar aftësitë mësimore të studentëve, për të lehtësuar kohën e tyre në klasë dhe për t'i përgatitur ata që të përmirësojnë aftësitë e tyre mësimore në mënyrë të vazhdueshme pasi të kenë mbaruar klasën.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunikimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, planifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe më tutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshme për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe

i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të perfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjedisëve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Kapituj të zgjedhur nga shkathtësitë e TI**

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'ua tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe dizajnin e punimeve të ndryshme gjatë studimeve. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri mbi shkathtësitë e TI, që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore, profesionale dhe prezantime. - Të aftësojë studentët për zbatimin praktik të shkathtësive të TI.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727.

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Krijimi i ueb-it**

Qëllimi i lëndës është zhvillimi i nje ueb faqe të thjeshtë bazuar në standardet aktuale. Kerkon njohuri të gjuhës Hypertext Markup Language (HTML) dhe Cascading Style Sheets (CSS). Shumica e ueb faqeve përdorin imazhe në formë të banerave, logove, imazheve, ose skanimeve. Adobe Fireworks është ndërtuar si një mjet për të krijuar dhe manipuluar imazhet e dizajnuara për ueb dhe për të lejuar krijuesit të zgjedhin këto imazhe në mënyrë që të zvogëlojnë madhësinë e skedarit. Fireworks gjithashtu mundëson integrim të shkëlqyer me Dreamweaver. Kjo lëndë ofron një seri aktivitete që mundësojnë një hyrje gjithëpërfshirëse në HTML, CSS dhe krijimin e imazheve për ueb.

- **Dizajnimi i medimeve digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design.

- **Google aplikacione për edukim**

Përmbledhje konceptuale me udhëzime praktike për shfrytëzimin e potencialit arsimor të G Suite. Kjo i identifikon parimet e të mësuarit që e mundësojnë përdorimin efektiv të G Suite për të krijuar mjedise mësimore që rrisin komunikimin arsimor. Lënda është e organizuar në një seri modulesh. Modulet janë të bashkangjitur në një meni përmbledhëse, të cilat mund të qasen në faqen "Google" për edukim, e cila i organizon modulet me po të njëjtën radhitje me të cilën do të diskutohen në klasë.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë me interes shkencor. Lënda: Hyrje në Administrimin Publik duhet t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet themelore të administratës publike. Kujdes i posaçëm do t'i kushtohet ofrimit të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe të reformave të parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët, do të kenë mundësi të njoftohen dhe në mënyrë kritike t'i analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Meqë lëmi i studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja, si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike, rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimin e institucioneve të administratës publike, shërbimet e administratës publike, vendimarrjen në AP.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurojnë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu, i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve, të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinë për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë

drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontributojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Shkrimi dhe arsyetimi ligjor**

Qëllimi i lëndës është që të ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik studentëve të vitit të parë. Në këtë lëndë, do të përfitohen njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj).

- **Teknologjia reproduktive e asistuar dhe e drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim të theksoj faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për riprodhimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të riprodhimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: inseminimin artificial, in vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të dhuruar, riprodhimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritët nga studentët, që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për riprodhimin e qenies njerëzore.

- **Dhuna në familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo, është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë, pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imunë ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Hyrje në shkenca kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon tema, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

- **Probabiliteti dhe statistika e zbatuar**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënie të konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

- **E-tregtia**

Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët me konceptet themelore dhe me terminologjinë e e-tregtisë (e-commerce): ● historinë e e-tregtisë ● e-botën: e-biznesin dhe e-tregtinë ● modelet e biznesit për e-tregtinë ● sistemet e pagesave online ● marketingun online ● e-infrastrukturat. - T'u mësojë teknologjitë kryesore, të cilat janë të detyrueshme për

të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, “cookies”, etj. - Të bëhet aplikimi i konceptit “e-commerce” nga teoria në praktikë, duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive, si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. - Të sqarohet kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese / payment gateway). - Studenti të jetë në gjendje ta aplikojë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. - Studenti të jetë në gjendje t'i dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. - Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. - Studenti të jetë i njohur me internet dhe “cloud” shërbimet.

- **Hyrje në sistemet e informacionit**

Aims of the course program: To learn the basic concepts and the terminology of Information Systems: - Basic Information Systems concepts: hardware, software, networks; - E-World: e-business and e-commerce; - Developing Processes; To learn about the Information Systems and technologies that improve business values and various processes inside organizations; Applying IS concepts with various managing disciplines, during analysis, interpretation, assessments and decisions; To understand the process of redesigning organizations by using information systems; To describe the role of information systems in decision making; To examine information security, ethical, and social issues; To be familiar with the Internet, electronic commerce, and e-business; To prepare students to work on small scale projects, individual or group work, who by nature could fall into these categories: case studies, scientific research project, development projects or internship projects;

- **Etika profesionale e TI**

Lënda siguron qasje gjithëpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtrura në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i TI-së.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve, të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë paraparë që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuhë gjermane 1-4**

Me përfundimin e lëndës, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimi të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojariht në gjuhën gjermane.

- **Multikulturalizmi në mësimdhënien e gjuhës angleze**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi: Studentët pritet të jenë në gjendje të prezantojnë opinionet e tyre në lidhje me kulturën dhe globalizimit dhe e gjithë kjo reflektohet në procesin e arsimimit. Pritet të diskutohen tema lidhur me tolerancën, mirëkuptimin, dhe akomodimin e diversitetit. Ata, gjithashtu, do të punojnë drejt përgatitjes të eseve, ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipeve, paragjykimeve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Krijimi i modeleve arsimore për bashkëpunim multikulturor dhe zbatimi i tyre në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Zhvillimi i një strategjie arsimore që do të tregohet e suksesshme në situata ku mund të ketë tensione në mesin e studentëve për shkak të mungesës së tolerancës. Aftësitë për të vlerësuar: Përpunimi i portofolit individual të bazuar në parimet e arsimimit multikulturor dhe kapacitetit, si dhe identifikimi i rasteve kur ka mungesë tolerance, duke synuar zhvillimin e frymës së bashkëpunimit ndërkulturor. Njohuri dhe mirëkuptim: Njoftim me parimet

themelore të kulturës, relativizmit kulturor, arsimimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe adresimi i këtyre çështjeve në kuadrin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Aftësitë e të mësuarit: Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët, do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Arsyetimi dhe mendimi kritik**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët, do të jenë në gjendje që ta përmirësojnë mënyrën e tyre të menduarit, përmes të kuptuarit të strukturave të brendshme të procesit të menduarit dhe duke i rishikuar ato në kuadër të standardeve individuale dhe akademike. Ata, do të zhvillojnë strategji të vendimmarrjes, të bazuara në reflektim, arsye dhe logjikë. Përmes kësaj lënde, studentët, do të mësojnë se në bazë të cilave tendenca, ngjashmëri dhe supozime bazohen reflektimet e tyre, si dhe cilat kushte dhe pasoja lindin nga mënyra e tyre e menduarit. Ky mendim reflektues, nënkupton një rishikim aktiv, të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të gjitha besimeve individuale në lidhje me fundamentin që i mbështesin ato dhe konkluzionet që dalin prej tyre. Studentët pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë vendime të kapshme, të nevojshme në mjedisin e përditshëm në lidhje me profesionet e tyre të ardhshme.

- **Marrëdhëniet me publikun dhe mediat e reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do ta përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Media dhe shoqëria**

Mediat dhe Shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë, e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Hyrje në ekonomi dhe biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë, si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP), si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Parimet e menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: - T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. - Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëturtyshme

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit gjithnjë e më shumë kompani i përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'u përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negocimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhimi i projekteve**

Qëllimi lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës, ose të idesë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Plani i biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjësisë korporative sociale në ekonomitë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **Gjuhë frënge 1-2-3**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehjeje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

- **Gjuhë italiane 1-2-3**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratat.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjese të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Arsimim online dhe digjital**

Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në

informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatat në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Gjuhë angleze për bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lartë. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Lënda do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role , simulime, debate dhe diskutime.

- **Shkathtësi komunikuese në kontekst profesional në anglisht**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale në anglisht. Objektivat e lëndës përqendrohen në një gamë të gjerë mjedisesh dhe çështjesh profesionale. Studentët, do të hulumtojnë procesin e analizës së situatave të ndryshme të komunikimit dhe në përputhje me rrethanat do t'i kuptojnë ato.

- **Beletristike dhe argëtim**

Lënda synon të eksplorojë një sërë tekstesh tërheqëse dhe të njohura letrare (romane, fragmente, lektura dhe tregime të shkurtra), në mënyrë që të kuptohen dhe shijohen karakteristikat e zhanreve të ndryshme të njohura, duke përfshirë trillimet shkencore, letërsinë për të rinj dhe fantastikën. Ndër objektivat e lëndës, mund të përfshihen me sa vijon: të zhvilluarit e vetëbesimit të studentëve, rrjedhshmërisë dhe interesit për të lexuar në anglisht, të lexuarit e llojeve të ndryshme të romaneve dhe dhënies së përgjigjeve të logjikshme dhe të mprehta, me gojë dhe me shkrim, duke krijuar një lidhje midis përvojës personale, njohurive globale dhe/ose burimeve të tjera (leksioneve, teksteve të leximit, filmave) dhe tekstit të caktuar. Për më tepër, qëllimet janë transferimi i aftësive të përparuara të leximit në klasën e gjuhës së dytë dhe zhvillimi i këtyre aftësive, duke i bërë studentët lexues më të mirë në të dy gjuhët. Shkathtësitë e të lexuarit përfshijnë: përshkrimin, skanimin, parashikimin, të qëlluarit e fjalëve nga konteksti dhe leximin për një kuptim më të hollësishëm.

- **Letërsi angleze dhe filmi**

Kjo lëndë është e dedikuar për studentët e gjuhës angleze, si dhe studentët që duan të lexojnë, të kënaqen duke parë filma dhe duke i analizuar ata. Qëllimet e lëndës janë, si vijon: - të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit; - diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike; - analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese; - diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët; - paraqitja e perspektivave të ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore.

- **Gjuha maqedonase për terminologji juridike dhe të BE**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për kompetencë dhe performancë gjuhësore në fushën profesionale (d.m.th. në fushën e të drejtës dhe BE-së). Bëhet fjalë për një koncept të përqendruar te studenti (learner-centered approach), e që thekson zhvillimin e aftësive të komunikimit në fusha specifike, d.m.th. thellimin dhe përfundimin e aftësive për shprehje të përparuar me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde maqedonase. Materiali i synuar përfshin përmbajtje në lidhje me disiplinat profesionale, si dhe dokumente dhe materiale autentike. Vëmendje e veçantë i kushtohet zotërimit të terminologjisë profesionale dhe zbatimit të saj në kontekst të përshtatshëm gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për një larmi temash, si dhe të fitojnë aftësinë për të komunikuar në gjuhën maqedonase në një mjedis shumëgjuhësh dhe multikulturor.

- **Të menduarit kritik dhe arsimimi multikulturor**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi - Studentët duhet të jenë në gjendje t'i paraqesin opinionet e tyre

në lidhje me kulturën dhe globalizimin dhe ndikimin që këto procese e kanë në arsimin. Ata, duhet të jenë në gjendje të diskutojnë për çështje që lidhen me temat e tolerancës, mirëkuptimit dhe akomodimit e diversitetit. Ata, gjithashtu, do të punojnë drejt përgatitjes së eseve, ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipave, paragjytimeve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe edukimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit - Njohuri e plotë mbi temat, konceptet dhe polemikat qendrore, lidhur me teoritë multikulturore; - Aftësi akademike, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e kriterëve akademike; - Njoftim me perspektiva dhe tema të ndryshme nga sfera e multikulturalizmit si teori, politikë dhe praktikë. Aftësi për të vlerësuar - Kapacitet për të vlerësuar argumentet e autorëve që do të diskutohen; - Aftësi për analizë, vlerësim dhe respekt të perspektivave të ndryshme në lidhje me politikat multikulturore. Njohuri dhe mirëkuptim - Aftësi për të parashtruar dhe për t'u përgjigjur pyetjeve në lidhje me temat e diversitetit dhe multikulturalizmit; - Aftësi për t'i identifikuar sfidat e disa nga teoritë më të rëndësishme multikulturore; - Aftësia për të aplikuar vlerësim kritik me qëllim që t'i formojnë dhe të jenë në gjendje t'i analizojnë qëndrimet e veta mbi politikat multikulturore. Aftësitë e të mësuarit - Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Përkthim nga fusha e mas mediave**

Qëllimet e programit të lëndës Shkathtësitë komunikuese: Të zhvillojnë shkathtësi përkthimi dhe interpretimi përmes të folurit, dëgjimit, leximit dhe shkrimit me qëllim që të vendoset ndërkomunikimi Aplikimi i njohurive: Të prodhojnë gjuhë korrekte angleze në të folur dhe me shkrim; të zbatojnë dhe prodhojnë struktura korrekte në gjuhën në të cilën përkthejnë. Aftësia për vlerësim: Ta lexojnë tekstin me qëllim që të jenë në gjendje ta përkthejnë atë, ta lexojnë përkthimin me qëllim që ta kontrollojnë dhe korrigjojnë. Njohuritë dhe kuptimi: Ta përvetësojnë procesin e prodhimit të një teksti, të shkruar apo të folur, sipas variacioneve të folmeve dhe agjendave të ndryshme, të vendosin komunikim kompleks në kontekst të përkthimit Shkathtësitë e të mësuarit: Të aplikojnë parime dhe praktika të përkthimit si dhe interpretimit simulant dhe konsektiv.

- **Sigurimi i cilësisë**

Lënda do t'u mundësojë studentëve të njihen me historikun e sigurimit të cilësisë si koncept me origjinë nga sektori i biznesit, si dhe nevojën e zbatimit të parimeve bazë të këtij procesi në të gjitha fushat dhe organizatat, përfshirë edhe arsimin. Studentët pritet t'i kuptojnë segmentet dhe faktorët e ndryshëm që kontribuojnë në sigurimin e përgjithshëm të cilësisë në organizata, të tilla si puna ekipore, rëndësia e klientit dhe kënaqësia në sigurimin e cilësisë, por gjithashtu të krijojnë modele dhe korniza të ndryshme për sigurimin e cilësisë, matjen, përmirësimin dhe monitorimin. Theks i veçantë do t'i kushtohet implikimeve për zbatimin praktik të këtyre modeleve.

- **Mësimdhënia dhe nxënia e vokabularit**

Lënda mundëson informatat e reja të lidhura me mësimdhënien dhe nxënien e vokabularit në klasat e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Përfshinë përshkrim se si mësohet vokabulari, si përdoret në të folurit dhe në shkrim dhe diskutime për praktikën më të mira aktuale të mësimdhënies së vokabularit. Pyetjet specifike të përfshira në këtë lëndë janë: çfarë do me thënë të dish një fjalë, sa fjalë ka, cilat fjalë duhet të mësohen, në mënyrë të hapur është kundër mësimi të rastësishëm të vokabularit, vlera e leximit në mësimin e vokabularit, strategjitë e mësimi të vokabularit, teknikat e mësimdhënies së vokabularit dhe testimi i vokabularit.

- **Trendet moderne në arsim: CEFR**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët, mësimdhënësit e ardhshëm të anglishtes, me principet kryesore të CEFR (Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës Gjuhësore). Po ashtu, lënda ka për synim që të diskutojë mundësitë e përfshirjes së kësaj kornize në program studimor paralel me principet e saj në zhvillimin e shkathtësive gjuhësore. Zhvillimi i shkathtësive gjuhësore është shumë i rëndësishëm për arsye se i aftëson studentët të komunikojnë në anglisht, në mësim dhe mësimdhënien e anglishtes duke përfshirë situata reale jetësore.

- **Përkthim simultan**

Lënda është e dizajnuar në atë mënyrë që vë theks të veçantë në mbajtjen mend të fjalive të gjata, dhe njëkohësisht është hyrje në marrjen e shënimeve. Kompetencat dhe performanca në gjuhën shqipe dhe atë angleze, aftësia e analizimit të tekstit, aftësitë e komunikimit etj. kontrollohen dhe notohen në fund të semestrit.

- **Mësimi dhe njohja në procesin mësimor**

Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që: të njihen me supozimet themelore, konceptet dhe parimet e secilës teori; t'i kuptojnë implikimet e mundshme të secilës teori për cilësime të ndryshme mësimore; të krahasojnë dhe zbatojnë një varg teorish ndër moshat e ndryshme dhe në kushte të ndryshme; të krijojnë, të rishikojnë dhe të fillojnë të përdorin teorinë e tyre personale të të nxënies; të reflektojnë se si ndikojnë teoritë e të mësuarit në çdo aspekt të jetës së tyre; t'i shpjegojnë ndërveprimet e studentëve, ligjëruesve dhe materialeve në klasa dhe implikimet e këtyre bashkëveprimeve për mjediset në klasë; t'i përshkruajnë studentët bashkëkohorë në një vazhdimësi

karakteristikash, p.sh. statusi socio-ekonomik, etnia, gjinia, aftësia dhe të diskutojnë për implikimet e këtyre karakteristikave për mësim; t'i krahasojnë dhe t'i dallojnë pozicionet e mëdha teorike në mësim; ta shqyrtojnë motivimin dhe implikimet e tij për të mësuar dhe për të shfrytëzuar vetëvlerësimin me qëllim të reflektimit të vetvetes dhe zhvillimit të mëtejshëm profesional.

- **Mësimdhënia e anglishtes tek të rinjtë**

Lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me botën specifike të mësuarit të të rinjëve, t'i ndihmojë të bëhen mësimdhënës të mirë në një kuptim të përgjithshëm, si dhe në kuptim të veçantë, t'i përgatisë për mundësitë dhe sfidat me të cilat do të ballafaqohen. Poashtu, lënda fokusohet në përgatitjen e orëve, përgatitjes së planeve mësimore për të rinjtë, udhëheqjes së klasës dhe vlerësimit të të rinjve (nota dhe informata kthyesë). Me këtë lëndë hulumtohen aktivitetet në orë nga aspekti komunikativ.